

SIMFONIA E MENDIMIT

48 Analiza dhe ese mbi ekonominë, shqiptarët dhe marrëdhëniet në Ballkanin Perëndimor

Dr. Teuta NUNAJ-KORTOÇI

Me parathënie nga Prof. dr. Bamir Topi

Parathënie

Kjo përmbledhje artikujsh, të shkruar me një shqipe të pasur dhe e të përgatitur në mënyrë të kujdesshme dhe profesionale nga Dr. Teuta Nunaj-Kortoçi, na mundëson të njohim dhe të prekim nga afër segmente të veçantë, por shumë domethënëse të tranzicionit ekonomik shqiptar, por njëkohësisht edhe aktualitetin dhe perspektivën e *shqiptarëve* në rajon. Tek lexon artikujt, kupton lehtësisht profesionalizmin, dashurinë dhe lirinë e mendimit që udhëheqin pandalur punën e Dr. Nunaj në të dy fushat e saj të ekspertizës: ekonominë dhe marrëdhëniet e *shqiptarëve* në Ballkanin Perëndimor.

Dr. Teuta Nunajn e kam njohur 9 vite më parë, kur së bashku me një grup intelektualësh elitarë u organizuam dhe bashkëpunuan për të kontribuar në përmirësimin e demokracisë në vend. Znj. Nunaj ofroi profilin e mirëfilltë të një bashkëpunëtoreje kompetente, të pavarur dhe mendjehapur. Puna e saj karakterizohet nga forca e pareshtur për të punuar fort, nga zgjerimi i vazhdueshëm i dijes dhe nga rritja e pandalur e profesionalizmit.

Në librin e saj, Dr. Nunaj paraqet për publikun një panoramë të tranzicionit ekonomik në Shqipëri, por edhe të marrëdhënieve rajonale mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht realitetin e *shqiptarëve* në trevat autoktone, të cilat paraqesin interes të veçantë për profesionistët e fushës dhe jo vetëm. Ekonomia për Dr. Nunaj nuk mund të veprojë pa politikën, ndaj politikëbërja ekonomike është një nga treguesit kyç për zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe asaj rajonale. Njëkohësisht, mund të thuhet se funksionimi i duhur i rregullave të ekonomisë së tregut dhe të zhvillimit të demokracisë në Shqipëri është faktor vendimtar për të përcaktuar shkallën e zhvillimit të vendit dhe të mirëqenies së kombit tonë.

Si eksperte e ekonomisë, autorja përqendrohet në shtjellimin e situatës ekonomike në vend, evidenton shkaqet dhe ofron zgjidhje për problematika të ndryshme që shfaq tranzicioni i gjatë dhe i dhimbshëm politik, ekonomik dhe social në Shqipëri. Ndaj mund të thuhet se problematikat e shumta ekonomike të Shqipërisë dhe të rajonit janë trajtuar në një këndvështrim gjithëpërfshirës. Sugjerimet dhe zgjidhjet e ofruara nga Dr. Nunaj, jo vetëm i adresojnë këto problematika, por mund të shërbejnë si indicie për vendimmarrësit në hartimin e politikave publike dhe për thellimin e fushave të kërkimit shkencor.

Analizat e Dr. Nunaj mbi ndikimet e pandemisë Covid-19 në ekonominë shqiptare dhe atë europiane e aktualizojnë dhe pasurojnë edhe më shumë ekspertizën e saj. Përshkrimi i etapave më kryesore të zhvillimit të ekonomisë ndërkombëtare në shekullin e kaluar ndihmon në të kuptuarit edhe të ardhmërisë ciklike të zhvillimit ekonomik botëror për perspektivën.

Një pjesë e rëndësishme e librit janë edhe artikujt e Dr. Nunaj mbi analizën e zhvillimit dhe ecurisë së bashkëkombësve tanë në rajon, të cilat të ofrojnë një panoramë të qartë, të kthjellët dhe

aktuale të situatës së *shqiptarëve* në rajon. Analizat e saj janë të ftohta dhe pa ndikime emocionale, apo eufori partiake.

Të jetuarit në Shqipëri i ka mundësuar autores një njohje shumë të mirë të realitetit shqiptar, prekja nga afër e gjendjes së *shqiptarëve* në rajon dhe të zotëruarit e aftësisë shkruese në publicistikë dhe në kërkim shkencor, ndërthurur kjo me njohjet praktike, e kanë ndihmuar Dr. Nunajn të sjellë për publikun analiza të veçanta dhe shumë profesionale, gjë e cila i mundëson të kalojë lehtësisht nga njëri zhanër në tjetrin, duke i ofruar lexuesit perspektiva dhe këndvështrime të ndryshme profesionale.

Duke shqyrtuar ecurinë e mendimit dhe të analizave të saj të fokusuar në ekonomi dhe për *shqiptarët* në rajon, evidentohet aftësia e saj për të identifikuar problemet dhe për të ofruar zgjidhjet; konstatohet prezantimi i një panorame të shkaqeve të ekonomisë ende në zhvillim në Shqipëri, i rolit të politikës në tranzicion dhe i keqeverisjeve të marrëdhënieve mes *shqiptarëve* në rajon. Nunaj argumenton se zhvillimi i Shqipërisë dhe i *shqiptarëve* nuk mund të realizohet i shkëputur nga zhvillimi rajonal i Ballkanit Perëndimor.

Këta artikuj kontribuojnë në njohjen jo vetëm të realitetit të *shqiptarëve*, por edhe në zgjidhjet që ofrohen për përmirësimin e tij. Ndaj, ju rekomandoj ta bëni këtë libër pjesë të bibliotekës suaj.

Tiranë, më 05 / 05 / 2021

Prof. dr. Bamir Topi

President i Republikës së Shqipërisë, 2007–2012

Hyrje

Për mua personalisht, Tirana mbetet qyteti që e shpreh më shumë ekzistencën time. Në këtë qytet u linda, u rrita, u arsimova, hodha themelet e personalitetit tim dhe u zhvillova profesionalisht. Të jetuarit në dy kohë dhe në dy sisteme të ndryshme ekonomike, më ka mundësuar ta njoh, ta studioj, ta ndjej, si dhe ta kuptoj thellë brendësinë tonë si shoqëri – ende në tranzicion – si dhe të nevojave dhe të domosdoshmërive që ne kemi për ndryshim.

Çdo artikull, analizë apo esé, lindi së pari si ide, e cila u zbardh në çast, për t'u shtjelluar më pas në një tjetër kohë. Si zanafillë e ideve që më lindën më pas, ishin përjetimet e ngjarjeve konkrete që ndodhën në Shqipëri, njohja nga afër e jetës së *shqiptarëve* në rajon, dashuria për vendin tim, si dhe të rrëfyerit me sa më shumë vërtetësi mbi vendin tim. Të shkruarit për mua, u mbështet mbi parimin e mendimit të lirë, të pavarur dhe profesional, duke synuar të mos shpreh opinion, por të mbështetem vetëm mbi argumente rreth të gjitha çështjeve dhe ngjarjeve të trajtuara.

Përgjatë rrugëtimit të shkrimit të artikujve të mi kam pasur fatin të këshillohem nga individë dhe personalitete në fushat e tyre ku ata veprojnë. Për të gjitha këshillat e tyre të vyera, vlerësoj dhe falënderoj të ndjerin profesorin tim PhD Gilman Bakalli, z. Koço Kokëdhima, z. Besnik Mustafaj, z. Mentor Nazarko, si dhe z. Muharrem Salihu. I jam mirënjohëse prof. dr. Bamir Topit, për të gjithë mbështetjen dhe bashkëpunimin ndër vite, si dhe ndihem e nderuar për parathënien shumë domethënëse të tij për librin tim.

Libri përmban 48 analiza dhe esé mbi ekonominë, për *shqiptarët*, si dhe mbi marrëdhëniet në Ballkanin Perëndimor. Artikujt janë përzgjedhur vëmendshëm dhe janë përmbledhur në dy grup-tema kryesore: ekonomia dhe *shqiptarët*. Më tej, libri është ndarë në kapituj sipas tematikave. Në Kapitullin e Parë përfshihen analiza mbi zhvillimet ekonomike në Shqipëri. Në Kapitullin e Dytë vazhdohet me adresimin e çështjeve që lidhen me ekonominë dhe marrëdhëniet mes shteteve të Ballkanit Perëndimor. Në Kapitullin e Tretë analizohet situata e *shqiptarëve* në Ballkan, problemet, sfidat e përditshmërisë së tyre dhe perspektiva. Pandemia botërore Covid-19 e ndryshoi në tërësi normalitetin jetësor në të gjithë botën, duke sjellë, si rrallëherë deri më tani, krizë ekonomike me mbylljen e bizneseve dhe ndryshime të rëndësishme në mënyrën tonë të jetesës. Artikujt e Kapitullit të Katërt paraqesin një mori ndikimesh që solli pandemia në biznese, vende dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare e të asaj botërore. Kapitulli i Pestë përshkruan diskutimin për një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë në Shqipëri, për administratën publike. Kapitulli i Gjashtë dhe i fundit ka një tjetër qasje nga kapitujt e mësipërm; aty pasqyrohen qëndrime dhe analiza për individë që kanë shënuar historinë e Shqipërisë, apo për sistemet/sectorët me rëndësi jetike për të tashmen dhe ardhmërinë e vendit.

Esencën e përvojës time jetësore dhe studimore, si dhe cilësinë e mendimit intelektual e profesional i gjejmë të shprehura në pjesën e fundit të librit, ku në vend të përmbylljes kam pasqyruar aforizma dhe qëndrime për ngjarje të ndryshme, të cilat janë shprehur e shkruar nga unë ndër vite, dhe janë mbledhur ditë pas dite, për t'u pasqyruar të plota, domethënëse e përfituese.

Në krye të çdo kapitulli është vendosur një skicë, e krijuar me shumë përkushtim, pasion e profesionalizëm nga kolegu im Marin Nikolli. Ideja ime për to lindi shumë vite më parë, në vitin 2013, kur unë iu bashkova idesë së Marinit për realizimin prej tij të revistës online “*Pa fokus*”. Marini, pasi i lexoi artikujt, i pasqyroi artistikisht idetë themelore të çdo kapitulli në një skicë të vetme, të cilat vijnë të thjeshta, por me plot jetë, frymëzim dhe përsosmëri të ndjerë. Gjuha vizuale shoqërohet me simbolika domethënëse për ne, por veçanërisht edhe për familjen time, siç është xhamadani i Tropojës, në kujtim të vjehrrit tim, Dush Kortoçit.

I jam mirënjohëse Marinit për emocionin, ndjeshmërinë dhe shpirtin krijues artistik në realizimin e imazhit të Nënës sime, Salihe Nunajt, së cilës ia dedikoj me përulje këtë libër, si një nga njerëzit më të rëndësishëm të jetës sime, e cila më dhuroi pambarimisht dashurinë e çmuar prej mëme. Ishte Ajo që, në çdo kohë të rrugëtimit tim jetësor më mbështeti pa kushte dhe mbeti ngaherë Fuqia ime. Dashuria, dhe vetëm dashuria, është e do të mbetet kujtimi yt, Mam!

Ky libër u realizua edhe në sajë të përkrahjes e nxitjes së vazhdueshme të shtyllës së jetës sime, bashkëshortit tim Bashkim Kortoçi (Baçit), i cili është frymëzim i krijimit për mua dhe që në çdo çast më jep me dashuri dhe përkrahje të pakufishme, më të mirën e tij. I jam mirënjohëse familjes time, motrave Jeta e Merita, vëllait Bahir, të cilët me shumë përkushtim e dashuri më kanë lënë gjithnjë kohën e duhur për t'u rritur profesionalisht, por edhe më kanë mbështetur vazhdimisht për të ecur përpara. E falënderoj për zemërsisht edhe mikeshën time Holta Shano, këshillat e së cilës për këtë libër ishin shumë të vlefshme.

Unë kam lindur në kohën kur diktatura komuniste kontrollonte në çdo detaj jetën e *shqiptarëve*. Pjesën më të madhe të jetës sime e kam kaluar në një tranzicionin të gjatë e lëngues. Koha më mësoi vlerën që ka dhe mbart qetësia e mendimit, përqendrimi në vendimmarrje, liria e të shprehurit, zgjedhja me vetëdije e besimit; të gjitha këto më ndihmuan ta vlerësoja dhe ta çmoja përherë fatin tim të mirë.

Përulësisht i jam falënderuese Perëndisë, si dhe iu jam tepër mirënjohëse prindërve të mi, Babait Ali e Nënës Salihe Nunaj, të cilët më mësuuan si jetohe Jeta e lirë dhe me virtyte, të punuarit me pasion e dashuri, si të luftosh për të drejtat e tua pa u ndalur, të dashurosh me ndjenja e me zemër, të japësh e të dhurosh pa ta kërkuar e pa kërkuar gjë në këmbim, dhe se në jetë ecet vetëm me përpjekje të vazhdueshme. Dashuria, dija, puna, lutja – këto janë katër shtyllat, mbi të cilat unë ndërtova ngrehinën e jetës sime, të cilat vijojnë të forcohen çdo ditë e më shumë.